



KB4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ERZEN

Nr. 18/11 prot
dt. 08.01.2025

VENDIM

Nr. 16, datë 23/12/2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES ME
NR.SERIE 00002 MIRATUAR ME VENDIM NR.5 DATË 16.09.2020
“PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR
PRODHIM HIDROENERGJETIK”, HEC “HEKAL” TË
SHOQËRISË “AGE ERZEN” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes me Nr.serie 0002 miratuar me Vendimin Nr.5 datë 16.09.2020 “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik”, shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k., me vendndodhje, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, HEC “Hekal”, në Njësinë Administrative Ibë, Bashkinë Tiranë, sipas këtyre koordinatave:

Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC "HEKAL"

Vepra e marrjes:

- X= 497871
- Y= 4569551
- Z= 300 m
- $Q_{mes} = 4.7 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{llog} = 2.7 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{eko} = 0.4 \text{ m}^3/\text{s}$

Godina e Centralit:

- X= 494799
- Y= 4568162
- Z= 204.5 m
- Fuqia e instaluar N= 1,940 kW
- Energjia mesatare vjetore E= 6,733,365 kWh/vit.

2. Zbatimi i lejes për përdorim burimi ujqor nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
3. Subjekti të instalojë stacionet hidrologjik dhe metrologjik, në zbatim të Vendimit Nr. 1122, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujqore".
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ERZEN

AFRIM QËNDRO

